



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR

Nr. 6037 Prot

Shkodër, më 11.04.2019

VENDIM

Nr. 76, datë 11.04.2019

”PËR MARRJE TË NISMËS PËR HARTIMIN E PDV NË NJESINË SH010.UB SIPAS PPV”

Në mbështetje të neneve 8, pika 2, dhe 23, pika 14, të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetqeverisjen vendore”, neneve 5, pika 1.3, shkronja “b”, 13, 22, 33, të ligjit nr.107/2014 datë 31.07.2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, VKM nr. 686 datë 22.11.2017 “Për Miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit”, Planit të Pergjithshëm Vendore të Bashkisë Shkodër, miratuar me vendim të KKT Nr.5, datë 16.10.2017, si dhe në interesin publik të Bashkisë Shkodër:

Për hartim e PDV-së me nismë publike sipas P.P.V. të Bashkisë Shkoder, në njesinë strukturore me kod SH010.UB:

VENDOSA:

1. Të marr **nismën** për hartimin, e **P.D.V.** për njesinë strukturore me Kod SH010.UB ndërmjet rrugëve: « Marin Biçikemi », rr. «Pal Engjelli»,rr. «Sarda», rr. «Pjeter Bogdani», rr. «Marije Kraja», rr. « Zef Jubani», rr. « Justin Godard», rr. « Bulevardi Skenderbeu». Njësia, që do të studiohet, referuar përcaktimeve në pasaportat e dokumentit të Rregullores Vendore të Planifikimit, figuron me sipërfaqe 247 997.41 m².
2. Të urdhërojë Drejtorinë e Studimeve, Planifikimit dhe Koordinimit të Territorit, për hartimin e Relacionit Shoqërues të Nismës së PDV.
3. Pezullimin e dhënies së lejeve të reja zhvillimore/ndërtimore gjatë periudhës së hartimit të PDV, deri në miratimin e saj, me perjashtim te: a. zhvillime për të cilat leja e ndërtimit është miratuar, përpara vendimit për pezullimin e zhvillimit; b. punimet e mirëmbajtjes; c. zhvillime publike, shtetërore me interes vendor ose kombëtar.
4. Ngarkohet me ndjekjen dhe kontrollin e kësaj P.D.V Drejtoria e Studimeve, Planifikimit dhe Koordinimit të Territorit.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Vollana Ademi

